



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 260/ prot.

Pogradec , më 26.02.2026

Njoftim për konsultim publik

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONSULTIMIT PUBLIK, PËR PROJEKT VENDIMIN:

MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË POGRADEC"

Propozuesi : *Bashkia Pogradec.*

1.Sqarime për projekt-aktin:Nga Bashkia Pogradec është propozuar Projekt-Vendimi me titull: **MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË POGRADEC"** me qëllim konsultimin me banorët të Pkatesë Fiskale e cila nuk ka ndryshime por vetëm disa sistemime tek Drejtoria e Urbanistikës.

2.Kalendari i konsultimit : *Aktivitetet organizohen sipas kalendarit të konsultimit publik bashkangjitur këtij njoftimi*

Pjesëmarrës nga ana e Këshillit të Bashkisë :

- 1.1 Celnik Haxhillari (Kryetar)
- 1.2 Alketa Beka (Nënkryetare)
- 1.3 Mimoza Shuli (Sekretare)
- 1.4 Klajdi Gjona (Anëtar)
- 1.5 Klea Topa (Anëtare)
- 1.6 Vjollca Pllaha (Anëtare)
- 1.7 Ahmed Guxholli (Anëtar)
- 1.8 Jona Bojko Sekretare

Format e konsultimit :

- Konsultim me takime fizike.
- Vjelje mendimi nëpërmjet postës dhe postës elektronike.

Qëllimi i këshillimit publik

Duke qënë se në Projekt Vendimin e paraqitur nga administrata kërkohet :
"MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË

	BASHKINË POGRADEC" <i>Këshilli Bashkiak është i interesuar të marrë mendimet e banorëve .</i> <i>Kështu, Këshilli i Bashkisë kërkon mendime dhe sygjerime si më poshtë:</i> <i>1. A është komuniteti dakort ?</i> <i>2. Për të sqaruar këtë pyetje Këshilli fton të gjithë komunitetin të japin mendime dhe sygjerime me qëllim që çdo vendimarrje të jetë e dakortësuar dhe e favorshme për të gjitha grupet e interesit.</i> <i>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë mendimet e banorëve Bashkisë Pogradec dhe Njësive Administrative .</i> <i>Këshilli i Bashkisë kërkon mendime dhe sygjerime si më poshtë:</i> <i>3. A janë dakort banorët me paketën Fiskale e cila dhe pse nuk ka ndryshime por vetëm disa sitemime në disa seksione të caktuara.</i>
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	<i>Projekt -vendimi i propozuar kërkon që Këshilli i Bashkisë të miratojë Taksat dhe Tarifat në Bashkinë e Pogradecit.</i>
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	<i>Me qëllim për të orientuar (por jo kufizuar) mendimet dhe sygjerimet tuaja, këshilli ngre për ju disa pyetje për të dhënë mendime në mënyrë që të jetë sa më i qartë sygjerimi juaj dhe rrjedhimisht vendimarrja e Këshillit.</i> <i>- A jeni dakort me taksat dhe tarifat vendore?</i> <i>Çdo sygjerim tjetër është i mirëpritur.</i>
Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktet për këshillim;	<i>- Takimet fizike do të realizohen sipas kalendarit bashkangjitur për grupet e interesit duke përshtatur oraret për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të interesit pa penguar zhvillimin e aktivitetit të tyre normal.</i> <i>- Sygjerimet mund të dërgohen edhe me postë në adresën: Bashkia Pogradec, Bulevardi Rreshit Çollaku, Lagj. 2, Pogradec ose në adresën elektronike keshilibashkiakpogradec@gmail.com</i>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<i>Në pamundësi për të marrë pjesë në takimet fizike cdo banor, ose grup interesi mund të dërgojë sygjerimet e tij në postë në adresën: Bashkia Pogradec, Bulevardi Rreshit Çollaku, lagj. 2, Pogradec ose në adresën elektronike keshilibashkiakpogradec@gmail.com, deri në datë 26.03 .2026</i>

Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Bashkangjitur gjeni: - Projekt Vendimin e paraqitur. - Relacionin shoqërues
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<i>Këshilli i Bashkisë do të trajtojë me kujdes dhe seriozitet çdo sygjerim tuajin. Procesi i marrjes së mendimeve dhe sygjerimeve do të koordinohet nga sekretariati i këshillit dhe konkretisht:</i> - <i>Për çdo takim fizik do të mbahen proces verbalet me të gjitha sygjerimet dhe proces verbali do bëhet publik.</i> - <i>Do hartohet raporti përmbledhës me gjithë rekomandimet e marra nga takimet, pyetësi dhe anketimi si dhe ato të mbëritura me postë. Raporti do publikohet.</i> - <i>Rekomandimet do t'i dërgohen Kryetarit të Bashkisë për të dhënë mendimin e tij.</i> - <i>Përmbledhja e rekomandimeve dhe mendimet e Kryetarit të Bashkisë do paraqiten komisionit të Këshillit për ekonominë. (do publikohet).</i> - <i>Komisioni do shqyrtojë çdo sygjerim dhe mendim të kryetarit dhe do t'i propozojë Këshillit çdo rekomandim (do publikohet).</i> - <i>Vendimarrja e Këshillit për këtë çështje do zhvillohet publikë, on-line dhe vendimarrja do publikohet.</i>
Data e publikimit	<i>Datë 26. 02 .2026</i>

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO



Kalendar i konsultimit publik

Titulli i Projekt-aktit:

“MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË POGRADEÇ”

Propozuesi: *Bashkia Pogradec.*

Sqarime për projekt-aktin: Duke qënë se në Projekt-Vendim kwrkohet “**MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË POGRADEÇ**”

” në mbështetje të plotë të neneve 18, pika 1), 54 e Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Pogradec për “Konsultimin Publik” miratuar me VKB Nr. 42, datë 05/03/2020, si dhe Rregullores për ankesat, kërkesat dhe peticionet iniciativat qytetare të Këshillit Bashkiak Pogradec, miratuar me VKB Nr. 67, datë 01/06/2020, Kryesia e Këshillit me vendim Nr 05, datë 26/02/2026, vendosi kalimin e kësaj iniciative për konsultim publik me të gjitha grupet e interesit .

Grupet që do të konsultohen: Banorët e Bashkisë Pogradec.

○ Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1.	Takim me banorët Bashkisë Pogradec dhe NJ.Administrative.	26.03.2026	Salla e Këshillit Bashkiak	12:00	Takim publik	Diskutime.

Kryetar i Komisionit:Celnik Haxhillari

Sekretare e Këshillit: Jona Bojko

